



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 52  
Prishtinë, 10 janar 2010, në orën 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

**Morën pjesë:** Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj.

**Mungoi:** Mursel Halijli.

**Të pranishëm:** Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore,  
Nga – KDI; Rrezarta Ahmeti, nga OSBE – ja; Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.  
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2009;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.*

### **3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2009;**

**Sadik Idriz** – Tha se bashkë me rendin e ditës ju është dorëzuar raporti i punës njëvjeçare të komisionit. Mendoj që ky raport është i mirë, ka përfshirë atë çka ka punuar komisioni gjatë këtij viti. Ka çështje të cilat nuk janë përfunduar e të cilat janë paraparë me planin e punës së komisionit, por kjo jo me fajin e komisionit. Propozoj që ky raport të mos miratohet sot, por të dëgjojmë edhe komentet e anëtarëve të komisionit, ndërsa miratimin e tij do ta bëjmë në mbledhjen e radhës. Pasi të procedohet strategjia legislative e qeverisë për vitin 2010, ne si komision do të përgatisim planin e punës për këtë vit.

**Gjynaze Sylja** – Tha se raporti duhet të jetë më i detajuar. Të përfshihet edhe shqyrtimi i raportit të PVPE-së si dhe puna e grupeve punuese. Mundësisht të përfshihen edhe emrat e anëtarëve të grupeve punuese, sepse grupet punuese janë ato që kanë bërë një punë të madhe. Aktiviteti i komisionit duhet të pasqyrohet në mënyrë më të detajuar, pastaj takimet që komisioni ka pasur me ministrat dhe me përfaqësuesit e FES-it, me biokimistët etj.

**Nurishahe Hulaj** – Përgëzoi komisionin për punë e bërë gjatë vitit 2009. Raporti është i përgjithshëm dhe shumë përshkruar. Ne si komision kemi ngecur në shqyrtimin e projektligjeve të parapara në planin e punës, por jo me fajin e komisionit. Raporti duhet të përmbaj edhe një analizë rreth punës së komisionit si: çka është kryer, çka është dashur të kryhet dhe çka ka mbet pa përfunduar. Çështjet të cilat janë të papërfunduara a duhet të barten në këtë vit apo jo?

**Bujar Bukoshi** – Raporti për punën e komisionit për vitin 2009 është një raport i hartuar shumë mirë, nuk është voluminoz dhe ka pasqyruar punën e këtij komisioni për vitin 2009. Ne si komision duhet të mendojmë që çështjet të cilat nuk janë përfunduar pa fajin ton. Domethënë të gjejmë mënyra për ti tejkaluar ato neglizhencat, në mënyrë që komisioni të mund të përmbush planin e paraparë.

**Teuta Hadri** – Tha se ky raport është i punuar mirë, përshëndesë punuesit e tij dhe nuk kam vërejtje. Propozoi që komisioni në mbledhjen e radhës të ftoi në takim ministrin e MSh z.Alush Gashi, të raportoj për Ligjin për sigurime shëndetësore se çka mund të bëjmë që ai ligj të procedohet më shpejt.

**Rita Hajzeraj** – Tha se në raport janë përfshirë të gjitha çështjet të cilat i ka trajtuar komisioni gjatë vitit 2009. Propozoj që anëtarët e grupeve punuese të formuara nga ky komision për shqyrtimin e çështjeve të cekën me emra.

**Qamile Morina** – Ne si komision duhet të analizojmë përmbajtjen e punës sonë gjatë vitit 2009. Në raport figuron që ne si komision kemi bërë monitorimin e dy ligjeve gjë që nuk është e vërtetë, sepse Ligji për veprimtari private ne shëndetësi është monitoruar ne vitin 2008 dhe është finalizuar në vitin 2009, ndërsa Ligji për inspektoratin e punës - ne kemi filluar monitorimin, por nuk e kemi përfunduar. Domethënë në këtë vit ne nuk kemi arrit të përfundojmë monitorimin e asnjë ligji. Në këtë vit nga MSh-ja kemi vetëm një ligj. Pyetja është çka kemi mundësi të bëjmë ne si komision që të jemi si shtytje. Kemi realizuar dy vizita të cilat realisht kanë mbet në nivel të vizitave, pasi që ne nuk kemi nxjerr asnjë rekomandim. Kur të vendosim për vizita ne duhet të vendosim për qëllimin

vizitës, çka dëshirojmë të arrijmë me atë vizitë dhe çka do të jetë epilogu i krejt kësaj vizite.

**Flora Brovina** – Tha se nëse ne e kritikojmë raportin ne do të kishim vërejtje për vetveten, sepse ky raport pasqyron punën e këtij komisioni. Ne duhet të diskutojmë se si ta fuqizojmë komisionin që të kemi ndikim më të madh te ministrinë në nxjerrjen e ligjeve. Ne duhet të hartojmë planin e punës dhe sa i përket vizitave në spitale ne në radhë ta parë duhet të kërkojmë nga MSh-ja raport se si është gjendja në këto spitale e pastaj të realizojmë vizitën, në mënyrë që të dalim me përfundime konkrete nëse situata është ashtu siç ka raportuar ministria po jo.

**Qamile Morina** – Lidhur me Projektligjin për produkte medicinale tha se, para se ky projektligj të kaloi në lexim të parë, ne duhet të angazhojmë një ekspert për të na udhëzuar për të metat e këtij ligji në mënyrë që ne të jemi më efektiv.

**Sadik Idriz** – Tha se për të bërë planin e punës, ne do të presim strategjinë legislative, pastaj do të ftojme në takim edhe ministrat. Sa i përket Projektligjit për produkte medicinale, pasi që projektligji të miratohet në parim, ne si komision mund të organizojmë dëgjim publik.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E hartoi  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Sadik Idriz